



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1125/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Abdullah Vojvoda – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Vushtri, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1125, Anr.1126, të datës 03.12.2013, të Abdullah Vojvodës – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Vushtri.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1125, Anr.1126, të datës 03.12.2013, të Abdullah Vojvodës – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Vushtri, në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave. .

- Në ankesën Anr.1125/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2702X, 2701B, 2713B, 2723B, 2727B, 2728B mungojnë një numër i konsiderueshëm i votave, bazuar nga rezultatet e publikuara nga KQZ-ja, prandaj parashtresesi i ankesës kërkon që QV të rinumërohen
- Në ankesën Anr.1126/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2702B, 2709B, 2706B, 2707B, 2708B, 2714B, 2729B, 2717B i mungojnë një numër i konsiderueshëm i votave, bazuar nga rezultatet e publikuara nga KQZ-ja prandaj kërkon që QV të rinumërohen.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Abdullah Vojvodës – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Vushtri, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhorë (KQZ), ku dyshohet për parregullsi dhe keqpërdorime si dhe mungesë të konsiderueshme të votave nëpër QV, parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë relevante me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1125/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.